



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**

**K.P.P.274/2020**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.07.2020 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e BOE “Bean” shpk & “ED Konstruksion” shpk & “Almo Konstruksion” shpk & “Kombi Invest” shpk në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr.REF-56538-04-22-2020, me objekt “*Rikonstruksioni i rrugës Polis dhe Babje në Bashkinë Librazhd*”, me fond limit 333,331,666 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 26.05.2020 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

**Ankimues:** “Vëllezërit Hysa” shpk  
Banjë e re, Klos NjA Cërrik Elbasan

**Autoriteti Kontraktor:** Fondi Shqiptar i Zhvillimit  
Rruga “Sami Frashëri” nr.10, Tiranë

**Subjekt i Interesuar:** “Bean” shpk & “ED Konstruksion” shpk & “Almo Konstruksion” shpk & “Kombi Invest” shpk

Rruga "Frederik Shiroka", Ndërtesa 6, Hyrja.10, Ap.6  
Tiranë

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*"

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

**II**

## Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 22.04.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr.REF-56538-04-22-2020, me objekt “*Rikonstruksioni i rrugës Polis dhe Babje në Bashkinë Librazhd*”, me fond limit 333,331,666 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 26.05.2020 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.2. Në datën 26.05.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 01.06.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Bean	167,722,409	I kualifikuar
- Vëllezërit Hysa	169,242,496	I kualifikuar
- Sireta 2F	169,999,999	I skualifikuar
- K.M.K	176,057,236	I skualifikuar
- Agbes Konstruksion	177,657,867.60	I skualifikuar
- 4 A-M	190,305,715.07	I kualifikuar
- Albavia	192,834,352	I kualifikuar
- Ulëza Ndërtim	197,408,819	I skualifikuar
- Erniku	199,379,612.57	I skualifikuar
- Bami	203,335,768	I kualifikuar
- Biba –X	206,998,964	I kualifikuar
- 2T	210,131,542.35	I kualifikuar
- Alko Impex General	210,723,701.49	I kualifikuar
- Bajrami N	213,011,581.43	I kualifikuar
- Alb Building	216,758,135.86	I kualifikuar
- Kupa	217,692,101	I kualifikuar
- Arifaj	219,584,124	I kualifikuar
- Ergi	222,717,664.37	I kualifikuar
- Pepa Group	226,624,454.54	I kualifikuar
- Curri	231,100,415.18	I kualifikuar
- Hastoci	231,848,033.60	I kualifikuar
- Agi Kons	244.973,505	I kualifikuar
- Geci	246,773,840.98	I kualifikuar
- Zdravo	249,178,450	I kualifikuar
- Gener 2	259,854,545.50	I kualifikuar
- Fusha	283,258,203	I kualifikuar
- Gjiguria	303,333,593.80	I kualifikuar

II.4. Në datën 04.06.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së lidhur me kualifikimin e BOE “Bean” shpk & “ED Konstruksion” shpk & “Almo Konstruksion” shpk & “Kombi Invest” në procedurën e prokutiimit objekt ankimi në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Një nga pjesëtarët e këtij BOE konkretisht operatori Bean shpk nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e pikës 2.3.6 të kriterëve të vecanta të kualifikimit (licence e tij është e parregullt për shkak të mospërputhjes së drejtuesit ligjor të licencës me drejtuesin ligjor sipas QKB.*
- *Në këtë pikë është kërkuar: 2.3.6 Operoret ekonomike duhet të disponojnë licensat e nevojshme për zbatimin e kontrates. Per kete duhet te paraqesin licensen perkatese te shoqerise, bazuar ne formatin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi”. Shqyrtimi i licensave do te behet mbi bazen e rregullave te parashikuara sa me siper. Licensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates duhet te permbaje kategorite e meposhtme:*
- **PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI**
  1. N.P – 1. B Punime gjurmimi në tokë.
  2. N.P – 4. D Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
  3. N.P – 5. C Punime nëntokësore, vepra arti.
  4. N.P -- 7 A Ujësjiellësa, Gazsjiellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje
  5. N.P – 11 A Ndërtim për nënstacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
  6. N.P – 12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit

#### **PUNIME SPECIALE NDERTIMI**

1. N.S – 1. A Punime për prishjen e ndërtimeve
2. N.S – 6. A Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.
3. N.S – 7. A Barrierra dhe mbrojtje rrugore.
4. N.S -- 8 A Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri
5. N.S -- 9 A Punime strukturore speciale
6. N.S – 10 A Shtresa dhe mbistruktura speciale
7. N.S – 18 A Punime topogjeodezike

*Pra shqyrtimi e vlerësimi i licensave do të bëhej sipas përcaktimeve të VKM 42/2008.*

*Në [ëë.infrastruktura.gov.al](http://ëë.infrastruktura.gov.al) rezulton se operatori Bean shpk është i pajisur me licencë zbatim të punimeve në ndërtim NZ.2835/22 datë lëshimi 18.03.2019 ku drejtues ligjor është*

znj. Dorina Kuqari (bashkëlidhur lista e shoqërive që disponojnë licencë të vlefshme zbatimi shkarkuar nga ËEB i MIE ku nr.486 është përshkrimi për licensën e BEAN shpk.

Ndërkohë që sipas ekstraktit të QKB drejtues ligjor e BEAN që nga data 11.01.2020 është vetëm z. Gentian Kurti. Bashkëlidhur ekstrakti i QKB i shkarkuar nga [ëëë.qkb.gov.al](http://ëëë.qkb.gov.al)

Pra vërehet se Bean shpk ka mospërputhje të drejtuesit ligjor të pasyruar në licencë me drejtuesin ligjor sipas ekstraktit të QKB.

Në kreun III kategorizimi dhe klasifikimi i licencës elementët e saj kushtet, kriteret dhe kufizimet pika 2 dhe pika 3 gërma a paragrafi 2 të VKM nr.42 datë 16.01.2008 parashikohet se 2. Elementet e licencës: a) Licenca përmban këto elemente: I. Kategoritë e punimeve të ndërtimit (përcaktuar në lidhjen nr.2); II. Klasifikimin me nivele për çdo kategori (përcaktuar në lidhjen nr.4); III. Numrin e identifikimit; IV. Datën e regjistrimit në Regjistrin Themeltar (e njëjtë me datën e marrjes së vendimit nga komisioni); V. Emrat e drejtuesve ligjorë e teknikë; VI. Selinë; VII. Afatin e vlefshmërisë; VIII. Elementet e sigurisë të përcaktuara me urdhër të ministrit; IX. Të dhënat e plota të kategorive dhe klasifikimit, në pjesën e pasme të licencës (Lidhjet 2 e 4 të kësaj rregulloreje. Në kreun e I Qëllimi fusha e veprimit të rregullores dhe përkufizime pika 2 e VKM nr.42 datë 16.01.2008 parashikohet se “Drejtues ligjor”-personi fizik apo personat fizikë (administrator për sh.p.k., drejtor, presidenti për sh.a., personi fizik) të përcaktuar si të tillë nga vendimi i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit/ ose në gjykatë.

Kreu II pika 5 parashikohet se Brenda 30 ditëve, çdo subjekt i licencuar në zbatim ka detyrimin të depozitojë aplikimin për përditësimin e të dhënave që nuk sjellin ndryshim në klasifikim

Ndryshim apo shtesë të drejtuesit /ve ligjor të shoqërisë dhe në vijim kreu VII përcakton se II. Shoqëria kryen veprimtari pa drejtues teknik ose shkel afatet e njoftimit të caktuara në këtë rregullore. Në këtë rast komisioni heq licencën për shoqërinë/drejtuesit për një periudhë 3 vjet.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm KVO (referuar praktikës së vendimarrjes të KPP për rastet e mospërputhjes së drejtuesit ligjor të licencës me administratorin sipas QKR-së) do duhej të ishte vlerësuar se licenca e lëshuar për shoqërinë Bean shpk megjithse është lëshuar nga institucioni përgjegjës shfaq të meta dhe nuk përmbush të gjitha detyrimet ligjore të parashikuara nga akti normativ në zbatim të ligjit VKM nr.42 datë 16.01.2008.

Kjo sepse për Bean shpk Gentian Kurti është emëruar administrator më datë 11.01.2020 referuar dhe në zbatim të detyrimeve të mësipërme ligjore Bean shpk duhej që brenda datës 10.02.2020 (brenda 30 ditëve) të pasqyronte ndryshimet përkatëse në licencën e shoqërisë. Referuar pikës 5 gërma a dhe b të kreut II të VKM nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi është dettrim ligjor i cdo subjekti të licensuar në zbatim që të aplikojë për përditësimin e të dhënave.

*Madje edhe në kreun e faqes së listës të shoqërive që disponojnë licencë të vlefshme zbatimi që boton MIE është e shkruar e zezë mbi të bardhë që licenca është e pavlefshme nqs se ka ndryshuar emri i drejtuesit ligjor sic është rasti i shoqërisë Bean shpk.*

*Licenca është e pavlefshme nëse ka ndryshim në një nga elementët e mëposhtëm: Emri i subjektit, emrat e drejtuesve ligjorë e teknike, selinë, afatin e vlefshmërisë.*

*Për sa më sipër dokumentacioni i paraqitur nga anëtari i BOE Bean shpk në këtë procedurë prokurimi nuk plotëson kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.*

*Në këtë rast KVO duhet të respektonte praktikën e vendimarrjeve të KPP si organ më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve sic janë vendimet KPP 55/2016, KPP 203/2016 dhe KPP 502/2017.*

*Madje në vendimin KPP 502/2017 operatori është skualifikuar thjesht e vetëm për këtë arsye të mospërputhjes së drejtuesit ligjor sipas ekstraktit të QKB me licencën e shoqërisë.*

- *Një nga pjestarët e këtij BOE konkretisht operatori Kombi Invest shpk nuk ka licencë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim duke mosplotësuar pikën 2.3.6 të kriterëve të përgjithshme për kualifikim (nuk ka paraqitur licencë të rregullt zbatimi punimesh në nsërtim të vlefshme sipas përcaktimeve të VKM 42/2008).*

*Sipas [ëëë.infrastruktura.gov.al](http://ëëë.infrastruktura.gov.al) rezulton se me licencë zbatimi të punimeve në ndërtim NZ.7562 datë lëshimi 07.08.2017 ku drejtues ligjor është z.Ulis Gjata është i pajisur subjekti Kombi 2 Konstruksion shpk. (bashkëlidhur lista e shoqërive që disponojnë licencë të vlefshme zbatimi shkarkuar nga ëëb i MIE ku nr.1482 është përshkrimi për licencën e Kombi 2 Konstruksion shpk).*

*Ndërkohë që sipas ekstraktit të QKB që nga data 28.05.2019 Kombi 2 Konstruksion ka ndryshuar emrin në Kombi Invest shpk (Bashkëlidhur ekstrakti i QKB i shkarkuar nga [ëëë.qkb.gov.al](http://ëëë.qkb.gov.al)).*

*Pra vërehet qartë se Kombi Invest shpk ka mospërputhje të emrit të shoqërisë sipas ekstraktit të QKB me emrin e licencës.*

*Pra operatori Kombi Invest përvec se ka mospërputhje të emrit të licencës me emrin në QKB gjithashtu nuk i përputhet ashtu si edhe Bean shpk edhe drejtuesi ligjor sipas Licencës me drejtuesin ligjor sipas QKB.*

*Në licencën e paraqitur NZ.7562 datë lëshimi 07.08.2017 është drjetues z.Ulsi Gjata kurse sipas QKB që nga data 18.07.2016 është z.Kreshnik Gjata.*

*Referuar pikës 5 germës 4 dhe b të Kreut II të VKM nr.42 datë 16.01.2008 është detyrim ligjor i cdo subjekti të licensuar në zbatim që të aplikojë për përditësimin e të dhënave.*

*Madje edhe në kreun e faqes së listës të shoqërive që disponojnë licencë të vlefshme zbtimi që boton MEI është e shkruar e zezë mbi të bardhë që licenca është e pavlefshme nqs ka ndryshuar emri i drejtuesit ligjor sic është rasti edhe i dy shoqërive Bean shpk dhe Kombi shpk.*

- *Dy nga pjestarët e këtij BOE konkretisht Bean shpk dhe Almo Konstruksion shpk nuk plotësojnë pikën 1. d të kriterëve të përgjithshme për kualifikim (nuk kanë paguar detyrimet e sigurimeve shoqërore për punëmarrësit e tyre sipas legjislacionit të aplikueshëm në fuqi). Në këtë pikë është kërkuar: Ofertuesi duhet të deklarojë se: ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.*

*Në zbatim të legjislacionit në fuqi Ligji Nr.7703 datë 11.05.1993 i ndryshuar, Udhëzimi Nr.23 datë 09.12.2014 , Kodi i Punës së RSH , operatorët ekonomikë Bean dhe Almo Konstruksion në cilësinë e punëdhënësit duhet të paguanin detyrimet për kontributet e punëdhënësit për sigurimet shoqërore e shëndetësore për të punësuarit me kohë të pjesshme referuar pagës minimale me VKM që është 26 mijë lekë muaj.*

*Por nga dokumentacioni që disponojmë për shkak të eksperiencave të mëparshme të bashkëpunimit me ta në listpagesat e tyre rezulton se ata kanë një numër të madh të punësuarish me kohë të pjesshme disa ditë në muaj. Janë të njëjtët të punësuar që përsëriten në cdo muaj të periudhës së kërkuar në DT pika 2.3.2. të KVK për Muajt Dhjetor 2019-Shkurt 2020.*

*Për këta të punësuar operatorët Bean shpk dhe Almo Konstruksion shpk duhet të derdhin kontributin e sigurimeve shoqërore referuar pagës mujore bruto 26 mijë lek muaj. Por në fakt rezulton se ata i kanë paguar detyrimet për sigurimet shoqërore referuar pagës reale të tyre për ditët e punës që kanë punuar prej 2,3,4 apo 5 ditë në muaj.*

*KVO në këtë rast për këta operatorë nuk ka zbatuar përcaktimet e nenit 45 pika 2 e LPP ku shprehimisht parashikohet: Cdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesmarrja në një procedurë prokurimi në rastet kur: Nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore në pëpruthje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme të shtetit të origjinës.*

*Deklarimi i bërë nga Bean shpk dhe Almo Konstruksion shpk në shtojcën 8 Deklartaë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme e DT përmban deklaram të pasaktë.*

*AK e ka detyrimin ligjor të bëjë verifikimin e vërtetësisë së informacionit të përcjellë në këtë deklaratë.*

- *Kontrata e bashkëpunimit e paraqitur nga BOE është e parregullt dhe nuk është hartuar në përputhje me përcaktimet e nenit 74 të VKM nr.914 datë 29.12.2014. KVO duhet të skualifikonte këtë BOE sepse në kontratën e bashkëpunimit që kanë paraqitur*

si pjesë të ofertës nuk kanë të përcaktuar elementët konkretë që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Ata në kontratën e bashkëpunimit kanë ndarë % e punëve që do të kryejë secili por nuk kanë përcaktuar elementët konkretë të punës që do të kryejë secili anëtar i BOE.

Skualifikimi për këtë arsye pra të mospërcaktimit të ndarjes konkrete të punëve në kontratën e bashkëpunimit është praktikë rutinë e vendimarrjes së KPP por edhe e juaja si AK në procedura të mëparshme prokurimi prandaj referuar parimeve të koherencës dhe qëndrueshmërisë në vendimarrje të përcaktuara në KPRA ky standart duhet të ishte aplikuar edhe në rastin e këtij BOE.

Në praktikën e Bean shpk kontratës së bashkëpunimit i bashkëlidhet preventivi i ndarjes së punëve por ky preventiv nuk nënshkruhet e vuloset nga sejcili prej pjesëtarëve anëtarë të BOE.

Prandaj KVO duhet të skualifikonte këtë BOE sepse preventivi i ndarjes së punëve është i panënshkruar e vulosur nga pjestarët e tjerë të BOE si Kombi Invest shpk, Almo Konstruktion shpk dhe ED Konstruktion shpk.

Mungesa e nënshkrimeve dhe vulës së sejcilit prej anëtarëve të BOE de jure dhe de facto dëshmon se ky BOE nuk arrin të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të rregullt për elementët konkretë që do të kryejë secili pjestar i BO. Sipas përcaktimeve të nenit 74 pika 2 e VKM nr.914 duhet të firmoset dhe vuloset nga sejcili prej anëtareve të BO.

- KVO ka vepruar me standart të dyfishtë në kundërshtim me përcaktimet e nenit 2 të LPP për mosdiskriminim e trjtim të barabartë të ofertuesve përcatimeve të KPRrA për qëndrueshmëri e koherencë në vendimarrje të organeve të administratës publike si dhe shënimit të vënë në fund të shtojcës 12 të DT.

Në këtë shënim është përcaktuar shprehimisht: Shënim: Operatorët ekonomikë/anëtarët e bashkimit/eve të operatorëve ekonomikë që do të ofertojnë për më tepër se një objekt prokurimi të shpallur nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit 3 muajt e fundit brenda të njëjtit program apo programeve të ndryshme, duhet të plotësojnë kriteret e veçanta për kualifikim (financiare dhe teknike) në mënyrë kumulative sa shuma e objekteve ku do të ofertojnë. Këtu do të përfshihen procedurat e deklaruara në Shtojcën 11 por edhe procedurat për të cilat operatorët ekonomikë/anëtarët e bashkimit/eve të operatorëve ekonomikë janë shpallur fitues apo vlerësuar në vend të parë për procedura të publikuara nga FSHZH.

Në Buletinin nr.30 të njoftimeve publike të app është botuar njoftimi i fituesit të procedurës së prokurimeve “Rivitalizim i Rrugës Andon Profka dhe I hapësirave përreth saj Bashkia Fier REF-55009-03-26-2020.

Në këtë procedurë të cilën ne Vëllezrit Hysa kemi marrë pjesë si BOE së bashku me Bean është shpallur fitues BOE Almo Construction shpk 38 % , Eurondërtimi 2000 shpk 50.5%, Jubica shpk 11.5%. Vlera 70,467,769 lekë pa tvsh.



Nga Njoftimi i fituesit në bulletin por edhe nga fakti se ne kemi qenë pjesmarrës në këtë procedurë e njohim faktin se Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 06.05.2020. Po në këtë njoftim fituesi është dhënë informacioni se ankesa nuk ka patur dhe se operatori Shkëlqimi 07 shpk është skualifikuar.

Pra që më datë 06.05.2020 Almo Konstruksion shpk është njoftuar se është vlerësuar në vend të parë dhe më datë 13.05.2020 që ka mbaruar afati ligjor i ankimit sipas parashikimeve ligjore BOE ku bën pjesë edhe Almo Konstruksion shpk është klasifikuar në vend të parë dhe de facto është i shpallur fitues.

Nëse ju si AK nëpërmjet KVO në rastin konkret do të respektoni standartin e vendosur në këtë procedurë atëherë BOE Bean” shpk & “ED Konstruksion” shpk & “Almo Konstruksion” shpk & “Kombi Invest” shpk duhet të skualifikohej nga procedura objekt prokurimi sepse njëri nga pjestarët e këtij BOE konkretisht Almo Konstruksion shpk është shpallur fitues në procedurën e prokurimit Rivitalizim i Rrugës Andon Profka dhe i hapësirave përreth saj Bashkia Fier REF-55009-03-26-2020, duke mos plotësuar kriterin kumulativ në staf, makineri dhe licenca.

Ju kujtojmë se Almo KONstruksion ka të punësuar jo m shumë se 78 punonjës , 8 ing të profileve të ndryshme nga një për cdo profil dhe licencë NZ 2306/15 datë lëshimi 12.07.2019 është icencë modeste me kategori dhe pika licence dhe nuk i plotëson në mënyrë kumulative me vlerën e kontratave ku po shpallet fitues.

Duke qenë se kontratën ku është shpallur fitues Almo Kostruksion referuar numrit të punëtorëve të kërkuar në DT dhe % së marrë përsipër në akt marrëveshje 38 % ka të zënë 36 punonjës dhe i mbeten të lirë 42 punonjës.

Në procedurën objekt ankimi Almo Konstruksion shpk e më shumë se 23.3 % të punimeve përbën mosplotësim të kriterit për fuqi punëtore në proporcion me % sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit dhe KVO do të duhej të skualifikonte qoftë edhe vetëm për këtë arsye.

Për sa më sipër KVO nuk ka respektuar standartin e vendosur nga vetë AK juaj sepse një prej pjestarëve të BOE nuk ka arritur të plotësojë në mnëyrë kumulative numrin e fuqisë punëtore ing dhe licencë.

- BOE duhet të skualifikohej edhe sepse së paku dy prej OE konkretisht Bean dhe Almo Konstruksion shpk nuk kanë arritur të dëshmojnë dhe paraqesin dokumentacion të plotë dhe të saktë për plotësimin e pikës 2.3.2 të kriterëve të vecanta të kualifikimit (nr i fuqisë punëtore me kohë të plotë në proporcion me % e marrë përsipër në akt marrëveshjen e bashkëpunimit).

Në pikën 2.3.2 të KVK është përcaktuar:

**2.3.2** Operatori Ekonomik duhet të ketë nje punësim mesatar i të paktën 180 punonjës **me kohë të plotë** pune për periudhën **Dhjetor 2019 – Shkurt 2020**, e vërtetuar kjo me:

Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Dhjetor 2019 – Shkurt 2020**.

Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Dhjetor 2019 – Shkurt 2020**, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në grafikun e punimeve, preventivin dhe orët e punës që duhet për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje Dhjetor 2019 – Shkurt 2020, tregon besueshmëri për autoritetin.

Pra janë kërkuar që për periudhën Dhjetor 2019-Shkurt 2020 nr i punëtorëve do të llogaritej për punëtorët me kohë të plotë. Me kohë të plotë sipas KP konsiderohen mesatarisht 22 ditë pune në muaj.

Për periudhën e kërkuar në DT për këta operatorë numri i fuqisë punëtore me kohë të plotë nuk është ai i vërtetimit të lëshuar nga organi tatimore. Kjo sepse së paku 20% e fuqisë së tyre punëtore (20% për Bean shpk dhe 15-16 % e Almo Konstruksion) paguhet me nga 2 deri në 5 ditë pune në muaj.

Nga ana e KVO në rastin më të mirë i janë referuar numrit të fuqisë punëtore referuar vërtetimeve të organit tatimor dhe nuk e kanë konfrontuar e analizuar këtë informacion së bashku me të dhënat që pasqyrohen në listpagesat që janë paraqitur nga operatorët.

Përderisa në pikën 2.3.2 të KVK është kërkuar punonjës me kohë të plotë atherë KVO kishte detyrimin të referohej listpagesave sepse aty pasqyrohen ditët e punës dhe aty dhe vetëm aty do të verifikonte nëse të gjithë punonjësit ishin apo jo me kohë të plotë pune.

Mqs se sipas përcaktimeve të nenit 74 të VKM 914/2014, numri i fuqisë punëtore duhet të përmbushet nga secili prej operatorëve në përputhje me % e marrë përsipër në akt marrëveshjen e bahskëpunimit atherë ky BOE duhet të skualifikohej edhe sepse nuk plotëson pikën 2.3.2 nga së paku dy prej operatorëve të këtij BO.

- BOE duhet të skualifikohej edhe sepse të paktën tre prej pjestarëve të këtij BOE konkretisht Bean shpk Almo Konstruksion shpk dhe Kombi Invest shpk nuk plotësojnë kriteret teknike e profesionale makineri e pajisje në proporcion me % dhe me natyrën e punëve të marra përsipër nga secili prej tyre në akt marrëveshje.

Kështu kontrata e furnizimit me asphalt e beton për përmbushjen e pikës 2.3./ 7/ 8 /9 e KVK Bean shpk e ka me Vëllezrit Hysa shpk dhe me objekt të përcaktuar për kontratën objekt prokurimi. Duke qenë se vlera e punimeve të asfaltit dhe betonit zë së

paku 40% të vlerës së kontratës por mqs se Bean shpk nuk ka nr e fuqisë punëtore dhe kontrata për punë të ngjashme për të përmbushur këto kritere në masën 40% atherë normal që Bean shpk ka marrë përsipër të kryejë më pak se 40% të punëve në akt marrëveshjen e bashkëpunimit. Në vijim të këtij arsytimi do të thotë që ED Konstruksion dhe Almo Konstruksion shpk të marrin përsipër punime në zëra asfaltim e betoni ndërkohë që nuk kanë në pronësi me qera apo kontratë furnizmi për asfalt apo beton. Marrja përsipër nga këta dy operatorë e punimeve me asfalt apo zëra me punime betoni për të cilat nuk kanë as kontratë furnizmi dhe as fabrikë asfalti apo betoni në pronësi apo me qera përbën mospërmbushje të pikës 2.3.2/7 dhe 2.3.2/8 cka është mospërmbushje e përcatimeve të nenit 74 të VKM 914/2014.

Nga ana tjetër Bean shpk nuk ka makineri e pajisje si fadromë me goma, eskavatorë, rrul ngjeshës, autobitumatrice, autobot uji, asfalto shtruese, kamione vetshkarkues në proporcion me natyrën dhe % e punëve të marra përsipër në akt marrëveshjen e bashkëpunimit. Kurse Kombi Invest shpk nuk ka asnjë makineri për zbatim punimesh në ndërtim referuar ekstraktit të QKB.

- BOE nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë në përputhje me % e marrë përsipër në akt marrëveshjen e bashkëpunimit për të dhësmuar plotësimin e pikës 2.3.1 të kritereve të vecanta për kualifikim (lidhur me eksperiencën për punët e ngjashme).

Në këtë pikë është kërkuar:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm **në një vlerë jo më të vogël se 50%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar nga operatori ekonomik gjatë tri vitet të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.  
**ose**
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është **në një vlerë jo më të vogël se dyfishi** i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

**Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmëndura e ben oferten të kualifikueshme.**

Ngjashmëria e kontratave do të bazohet në natyrën, kompleksitetin metodat/teknologjinë dhe ose karakteristika të tjera të përshkruara në raportin teknik.

Pika 2.3.1 germa a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin konkret as përfaqësuesi i këtij BOE dhe as anëtarët e tjerë të këtij bashkimi nuk plotëson as pikën a për një objekt të vetëm në vlerën sa 50% e fondit limit as pikën b për punë

të kryera sa dyfishi i vlerës së fondit limit, në raport me përqindjen e pjesmarrjes së tyre në bashkim.

*Konkretisht Bean shpk asnjë prej kontratave të realizuara prej tij nuk plotëson pikën a as b të kriterit. Gjithashtu kontratat e realizuara prej tij nuk janë të ngjashme dhe disa janë jashtë aftit tre vjeçar.*

*Po në fakt edhe operatorë të tjerë si psh ED Konstruksion shpk i cili është operatori që referuar të dhënave në open data dhe buletin të app është operatori që ka më shumë kontrata të fituara dhe zbatuara nuk arrin të dëshmojë se plotëson pikën b të kriterit për punë të ngjashme (totali i kontratave sa dyfishi i vlerës së fondit limit).*

*Duke qenë se ED Konstruksion shpk ka nr e fuqisë pënetore dhe Licencë që plotëson kriteret e kërkuara në DT atherë ndarja e punimeve pjestarët e BOE nuk kanë marrë parasysh që edhe ED Konstruksion duhet të kishte paraqitur kontratë të ngjashme në proporcion me % e marrë përsipër në akt marrëveshjen e bashkëpunimit.*

*Opertaori ekonomik Kombi Invest shpk nuk ka ansjë kontartë për zbatim punimesh në ndërtim e aq më pak ppunime me natyrën e kontratës objekt prokurimi. Ky operator ka vetëm një kontratë me bashkinë fier kontratë mallrash për blerje kontenierë dekor të vitit të ri automjet e veturë makinë teknoloohjike me vinc por asnjë kontratë për cfardo lloj natyre.*

II.5. Në datën 10.06.2020 me shkresën nr. 1148/2 prot operatori ekonomik ankimues “Vëllezrit Hysa” shpk, është vënë në dijeni në lidhje me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor .

II.6. Në datën 19.06.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr.1359/1 prot datë 01.07.2020 protokolluar me tonën me nr.609/2 prot datë 03.07.2020 me objekt “Informacion” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Vëllezrit Hysa” shpk mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së BOE “Bean” shpk & “ED Konstruksion” shpk & “Almo Konstruksion” shpk & “Kombi Invest” shpk me arsyetimin se *BOE duhet të*

skualifikohej edhe sepse së paku dy prej OE konkretisht Bean dhe Almo Konstruksion shpk nuk kanë arritur të dëshmojnë dhe paraqesin dokumentacion të plotë dhe të saktë për plotësimin e pikës 2.3.2 të kriterëve të vecanta të kualifikimit (nr i fuqisë punëtore me kohë të plotë në proporcion me % e marrë përsipër në akt marrëveshjen e bashkëpunimit).

Në pikën 2.3.2 të KVK është përcaktuar:

**Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar i të paktën 180 punonjës me kohë të plotë pune për periudhën Dhjetor 2019 – Shkurt 2020, e vërtetuar kjo me:**

Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Dhjetor 2019 – Shkurt 2020**.

Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Dhjetor 2019 – Shkurt 2020**, shoqëruar me formularet e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në grafikun e punimeve, preventivin dhe orët e punës që duhet për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje Dhjetor 2019 – Shkurt 2020, tregon besueshmëri për autoritetin.

Pra janë kërkuar që për periudhën Dhjetor 2019-Shkurt 2020 nr i punëtorëve do të llogaritej për punëtorët me kohë të plotë. Me kohë të plotë sipas KP konsiderohen mesatarisht 22 ditë pune në muaj.

Për periudhën e kërkuar në DT për këta operatorë numri i fuqisë punëtore me kohë të plotë nuk është ai i vërtetimit të lëshuar nga organi tatimore. Kjo sepse së paku 20% e fuqisë së tyre punëtore (20% për Bean shpk dhe 15-16 % e Almo Konstruksion) paguhet me nga 2 deri në 5 ditë pune në muaj.

Nga ana e KVO në rastin më të mirë i janë referuar numrit të fuqisë punëtore referuar vërtetimeve të organit tatimor dhe nuk e kanë konfrontuar e analizuar këtë informacion së bashku me të dhënat që pasqyrohen në listpagesat që janë paraqitur nga operatorët.

Përderisa në pikën 2.3.2 të KVK është kërkuar punonjës me kohë të plotë atherë KVO kishte detyrimin ti referohej listpagesave sepse aty pasqyrohen ditët e punës dhe aty dhe vetëm aty do të verifikonte nëse të gjithë punonjësit ishin apo jo me kohë të plotë pune.

Mqs se sipas përcaktimeve të nenit 74 të VKM 914/2014, numri i fuqisë punëtore duhet të përmbushet nga sejcili prej operatorëve në përputhje me % e marrë përsipër në akt marrëveshjen e bashkëpunimit atherë ky BOE duhet të skualifikohej edhe sepse nuk plotëson pikën 2.3.2 nga së paku dy prej operatorëve të këtij BO” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Operatorët ekonomikë ankimues “Bean” shpk & “ED Konstruksion” shpk & “Almo Konstruksion” shpk & “Kombi Invest” shpk kanë krijuar bashkimin e përkohshëm të shoqërive me anë të kontratës së bashkëpunimit lidhur para një noteri publik. Nga shqyrtimi i kontratës së bashkëpunimit rezulton bashkimi i përkohshëm i shoqërive është krijuar mbi zbatimin e objektit “Rikonstruksioni i rrugës Polis dhe Babje në Bashkinë Librazhd”.

Në nenin 3 “Pjesmarrja” të kontratës së bashkëpunimit përcaktohet se shoqëria Bean shpk 20%, Almo Konstruksion shpk 26%, ED Konstruksion shpk 50%, Kombi Invest 4 %. *Sejcila nga shoqëritë do të ofrojnë të gjitha mjetet logjistike, makineri, pajisje, kapacitete financiare teknike, profesionale si dhe në burime njërezore, eksperiencën e tyre si një grup i vetëm pavarëisht % së pjesmarrjes për realizimin sa më mirë të kontratës.*

III.1.2. Në shtojcën 12 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3.2 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

**2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar i të paktën 180 punonjës me kohë të plotë pune për periudhën Dhjetor 2019 – Shkurt 2020, e vërtetuar kjo me:**

- *Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Dhjetor 2019 – Shkurt 2020.*
- *Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Dhjetor 2019 – Shkurt 2020, shoqëruar me formularet e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.*
- *Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në grafikun e punimeve, preventivin dhe orët e punës që duhet për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje Dhjetor 2019 – Shkurt 2020, tregon besueshmëri për autoritetin.*

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se anëtarët e bashkimit të përkohëshëm të operatorëve ekonomikë ”Bean” shpk dhe ”Almo Konstruksion” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër kanë dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

”Bean” shpk

- Vërtetim Nr.T02305054 datë 22.05.2020 Për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesin për periudhën 06/17-04/2020 lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier.
- Listpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat për periudhën Nëntor 2019-Shkurt 2020.

”Almo Konstruksion” shpk

- Vërtetim Nr.T02128645 datë 24.04.2020 Për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesin për periudhën 05/17-03/2020 lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë.
- Listpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat për periudhën Dhjetor 2019-Shkurt 2020.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”*

III.1.5. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.6. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 8, parashikohet si më poshtë:

*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

*a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*

*b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

*c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratë”*

III.1.7. Në Kreun VIII (“Kushte të përgjithshme për zbatim”), neni 74 (“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”), pika 1, dhe 3 të VKM 914/2014 parashikohet se :

*“1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.....*

*2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se*

*bashkimi I operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.*

*“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.*

III.1.8. Referuar sa më sipër KPP konstaton se në kriterin e vecantë të kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht se *Operatori Ekonomik duhet të ketë nje punësim mesatar i të paktën 180 punonjës me kohë të plotë pune për periudhën Dhjetor 2019 – Shkurt 2020.*

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik referuar bazës ligjore të sipërcituar gjykon se përmbushja e kriterëve në rastin konkret duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen e marrë përsipër në kontaktin e bashkëpunimit. Komisioni pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga anëtarët e bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë konkretisht operatorit “Bean” shpk dhe “Almo Konstruksion” shpk në përmbushje të kriterit kualifikues lidhur me numrin mesatar të punonjësve për periudhën e kërkuar konstaton se “Bean” shpk referuar marrëveshjes së bashkëpunimit ka marrë përsipër kryerjen e 20 % të volumit të kontratës, kurse anëtari tjetër i bashkimit “Almo Konstruksion” shpk 26 % të volumit të punimeve në kontratë.

Nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi është kërkuar disponimi nga ana e operatorëve ekonomikë të një stafi prej 180 personash për periudhën Dhjetor 2019-Shkurt 2020 . Në rastin e bashkimit të operatorëve KPP gjykon se anëtari i bashkimit Bean shpk duhet të dëshmojë me anë të dokumentacionit të kërkuar për përmbushjen e kriterit se disponon (20% të numrit të kërkuar) një numër mesatar prej 36 punonjësish me kohë të plotë sikundër kërkuar në kriterin e vecantë të kualifikimit. Ndërsa anëtari tjetër Almo Konstruksion shpk i cili ka marrë përsipër 26 % të punimeve duhet të dëshmojë me anë të dokumentacionit të kërkuar për përmbushjen e kriterit se disponon një numër mesatar prej 47 punonjësish për periudhën e kërkuar me kohë të plotë.

III.1.10. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të paraqitur nga anëtari i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë Bean shpk rezulton se për periudhën e kërkuar disponon një numër mesatar punonjësish me kohë të plotë prej 32 punonjësish ndërsa pjesa tjetër e punonjësve rezulton me kohë të pjesshme. Gjithashtu edhe sa i takon anëtarit tjetër të bashkimit Almo Konstruksion shpk, KPP pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të dorëzuar për përmbushjen e kriterit konstaton se për periudhën e kërkuar disponon një numër mesatar prej 32 punonjësish me kohë të plotë ndërsa pjesa tjetër e punonjësve rezulton me kohë të pjesshme.

Në këtë kuptim Komisioni gjykon se anëtarët e bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Bean” shpk dhe “Almo Konstruksion” shpk janë në kushtet e mospërmbushjes së kriterit të vecantë të kualifikimit lidhur me numrin mesatar të punonjësve me kohë të plotë për periudhën e kërkuar në kriterin e vecantë të kualifikimit, pasi numri i punonjësve me kohë të



plotë që operatorët disponojnë është më i vogël se ai që duhet të plotësohej referuar VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e cila në nenin 74 pika 3 e cila parashikon shprehimisht se: "Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje".

III.1.11. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se me anë të kriterit të mësipërm, qëllimi i autoritetit kontraktor është vërtetimi se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dhe/ose anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë, në përputhje me nenin 74 pika 3 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar disponojnë stafin e nevojshëm ( fuqinë punëtore) në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Me anë të dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë "Bean" sh.p.k dhe "Almo Konstruksion" shpk nuk kanë vërtetuar se disponojnë fuqinë punëtore me kohë të plotë sikundër kërkuar në kriterin e kualifikimit, në përputhje me përqindjen e marrë përsipër për realizimin e kësaj kontrate.

Komisioni gjykon se përmbushja e kriterëve ekonomike, teknike, profesionale në rastin konkret është një detyrim që buron nga ligji i cili në mënyrë taksative kërkon përmbushjen e tyre nga të gjithë anëtarët e bashkimit. Ndarja në përqindje e kontributit dhe në terma konkretë të punëve për secilin anëtar të bashkimit nëpërmjet aktmarrëveshjes bëhet pikërisht në funksion të përmbushjes së kriterëve në atë masë apo në proporcion me atë që operatori ekonomik ka marrë përsipër të kryejë për realizimin me sukses të kontratës.

III.1.12. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. KPP gjykon se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe

nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

III.1.13. Gjithashtu, Komisioni sqaron se nëse operatorët ekonomikë do të kishin pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit kanë patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se *“ [...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit*

Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Bean” shpk & “ED Konstruksion” shpk & “Almo Konstruksion” shpk & “Kombi Invest” shpk nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi kriteri për disponimin e stafit të nevojshëm për realizmin e kontratës nuk është plotësuar në përputhje me përcaktimet në kriteri dhe parashikimet e nenit 74 të VKM së sipërcituar nga dy anëtarë të këtij bashkimi si më sipër analizuar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Vëllezrit Hysa” shpk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Vëllezrit Hysa” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të BOE “Bean” shpk & “ED Konstruksion” shpk & “Almo

Konstruksion” shpk & “Kombi Invest” shpk me arsyetimin se nuk përmbushin kushtin për kontrata të ngjashme”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Operatorët ekonomikë ankimues “Bean” shpk & “ED Konstruksion” shpk & “Almo Konstruksion” shpk & “Kombi Invest” shpk kanë krijuar bashkimin e përkohshëm të shoqërive me anë të kontratës së bashkëpunimit lidhur para një noteri publik. Nga shqyrtimi i kontratës së bashkëpunimit rezulton bashkimi i përkohshëm i shoqërive është krijuar mbi zbatimin e objektit “*Rikonstruksioni i rrugës Polis dhe Babje në Bashkinë Librazhd*”.

Në nenin 3 “*Pjesmarrja*” të kontratës së bashkëpunimit përcaktohet se shoqëria Bean shpk 20%, Almo Konstruksion shpk 26%, ED Konstruksion shpk 50%, Kombi Invest 4 %. *Sejcila nga shoqëritë do të ofrojnë të gjitha mjetet logjistike, makineri, pajisje, kapacitete financiare teknike, profesionale si dhe në burime njërzore, eksperiencën e tyre si një grup i vetëm pavarëisht % së pjesmarrjes për realizimin sa më mirë të kontratës.*

III.2.2. Në shtojcën 12 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3.1 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

### **2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën :**

- c. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar nga operatori ekonomik gjatë tri vitet të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.*  
**ose**
- d. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

### **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmëndura e ben oferten të kualifikueshme.**

*Ngjashmëria e kontratave do të bazohet në natyrën, kompleksitetin, metodat/teknologjinë dhe/ose karakteristika të tjera të përshkruara në raportin teknik*

***Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatori/et Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:***

- i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:*
  - 1. Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me;*
  - 2. Kontratën/at e Sipërmarrjes*
  - 3. Situacionin përfundimtar të objektit;*

4. *Fatura tatimore për çdo situacion punimesh*
5. *Aktin e kolaudimit;*

*Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj*

*ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/indokumentacionin e mëposhtëm:*

1. *Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:*
2. *Kontratën/at e Sipërmarrjes;*
3. *Situacionin përfundimtar të objektit;*
4. *Fatura tatimore për çdo situacion punimesh.*
5. *Akt kolaudimi objekti;*

*Pika 2.3.1 gërma a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

*Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:*

- *Kontraten e bashkimit të operatoreve dhe prokuren e posaçme të deklaruara në fazën e tenderimit;*

*Per kontratat e realizuara si Nenkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:*

- *Kontrata baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe*
- *Miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor*

III.2.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezultojnë se anëtari i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë "ED Konstruksion" shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- *Formular Vlerësimit lëshuar nga Bashkia Dropull lëshuar për ED Konstruksion shpk për kontratën me objekt "Restaurimi i rrugës hyrëse të Kisha Bizantine Lindjes Hyjlinese në Peshkepinë e Poshtme dhe fshatit Radat Bahskia Dropull". Dt fillimi e kontratës 26.07.2019; Datë mbarimi 30.09.2019 me vlerë të realizuar 28,968,072 lekë me tvsh, shoqëruar me kontratë, Akt Kolaudimi, Certifikatë e marrjes në dorëzim paraprak të punimeve Nr.1850/1 datë 16.10.2019, Situacion nr.1, situacion përfundimtar, Faturë Tatimore Shitje.*

- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Tiranë për ED Konstruksion dhe Alba Konstruksion shpk për realizimin e kontratës me objekt “*Ndërtim i shkollës 9 vjecare Kosova Tiranë*” me vlerë të realizuar të kontratës 260,072,649.30 lekë me tvsh. Dt e fillimit 25.07.2017; Dt mbarimi 26.09.2018. Ed Konstruksion ka realizuar 34.96 % të punimeve, Alba Konstruksion shpk ka realizuar 65.04 % të punimeve, shoqëruar me kontratë bashkëpunimi, certifikatë e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve, Kontratë Sipërmarrje, Situacion nr.6 përfundimtar, Situacion përfundimtar, Procesverbal Kolaudimi, Fatura Tatimore Shitje.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Kucovë për ED Konstruksion 73% shpk dhe Arkonstudio shpk 27% për realizimin e objektit “*Ndërtim i shkollës 9 vjecare 18 tetori*”, me vlerë të realizuar të kontratës 74,577,384 lekë me tvsh, dt fillimi 04.07.2019, dt mbarimi 24.04.2020, shoqëruar me kontratë, certifikatë e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve, Akt Kolaudimi, Situacion përfundimtar, Situacion progresiv, Fatura Tatimore Shitje.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Polican për ED Konstruksion shpk 60% dhe Totila shpk 40 %, për realizimin e objektit *Rehabilitimi i shëtitores Miqësia në përputhje të plotë me projekt zbatimin e objektit*, me vlerë të realizuar 27,459,552 lekë me tvsh dt fillimi 04.07.2016-dt mbarimi 10.10.2016.shoqëruar me kontratë sipërmarrje, Procesverbal Kolaudimi, Certifikatë e përkohshme marrjes në dorëzim, Situacion Përfundimtar, Fatura Tatimore Shitje.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Polican për BOE Totila shpk 25 %, ED konstruksion shpk 25%, Boshnjaku B 25%, Fled shpk 25%, për objektin *Rikonstruksion dhe asfaltim i rruges Prokue Bodure Kapinove*, me vlerë të realizuar 119,696,544 lekë me tvsh. Dt fillimi 05.07.2017, dt mbarimi 18.05.2018, Kontratë sipërmarrje, Akt marrje në dorëzim, Procesverbal Kolaudimi, Akt marëveshje, Fatura Tatimore,
- Formular Vlerësimi lëshuar nga ARRSH për 4 AM shpk 90% dhe ED Konstruksion shpk 10% për objektin Plotësimi dhe përfundimi i objektit *Ndërtim Unza e Re e Tiranës...*, me vlerë të realizuar të kontratës 1,048,817,925 lekë me tvsh. Dt fillimi 20.03.2017, Dt mbarimi 12.02.2018.Kontratë, Procesverbal Kolaudimi, Situacion përfundimtar, Fatura Tatimore Shitje,Fatura Tatimore Shitje,Kontratë Bashkëpunimi.
- Kontratë Sipërmarrje nr. 1461 prot datë 01.10.2018 lidhur ndërmjet Bashkia Patos dhe ED Konstruksion shpk me objekt Rikonstruksion i rrugës Koli Marku me vlerë 69,790,772 lekë me tvsh, Formular Vlerësimi, Situacion Progresiv, Situacion përfundimtar, Akt Kolaudimi, Certifikatë e përkohshme e marrjes në dorëzim,Fatura Tatimore Shitje.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga Bashkia Patos lëshuar për ED Konstruksion shpk 31.4 %, Fusha shpk 66.6 %, Arkonstudio 2% për objektin *Rikualifikim Urban i Shëtitores Republika* me vlerë të realizuar 96,285,204 lekë . dt fillimi 03.11.2016, dt mbarimi 30.11.2017.Kontratë Sipërmarrje, Situacion përfundimtar, Procesverbal Kolaudimi, Akt marrje në dorëzim.
- Formular Vlerësimi lëshuar nga UKT, ED Konstruksion shpk për objektin Ndërtim Ujësjellësi në rrugën Naim Frashëri me vlerë të realizuar 24,385,567 lekë me tvsh. Dt

filimi 19.04.2017, Dt mabrimi 16.6.2017. Kontrate Sipërmarrje, Akt Kolaudimi, Situacion përfundimtar, Kontratë për bashkim operatorësh.

III.2.4. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" parashikohet shprehimisht se: "*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*" b) aftësia teknike: *operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*"

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-se përcakohet se: "*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.*"

III.2.5. Referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", neni 26 "Kontratat për punë publike", pika 6 përcaktohet:

*Për të provuar përvojëne mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:*

- a) *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.*
- b) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

- *Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshmetë punëve.*
- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.*

III.2.6. Në Kreun VIII ("Kushte të përgjithshme për zbatim"), neni 74 ("Bashkimi i operatorëve ekonomikë"), të VKM 914/2014 parashikohet se:

*Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të*

kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me procure përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi I operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 6, të nenit 26, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

III.2.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit sa më sipër të dorëzuar nga anëtari i bashkimit ED Konstruksion shpk KPP vëren se në përmbushje të kriterit kualifikues lidhur me përvojën e ngjashme ky i fundit ka dorëzuar disa kontrata për punë publike. Referuar bazës ligjore të sipërcituar KPP gjykon se ndryshe nga kontratat e mallrave dhe ato të shërbimeve për kontratat me objekt punë civile të parshikuar në nenin 26 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 ligjvënësi ka parashikuar dy mundësi të përmbushjes së kriterit konkretisht punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Specifika qëndron në rastin e pjesëmarrjes në procedurë si bashkim operatorësh ekonomikë ku në nenin 74 pika 3 e VKM si më sipër cituar parashikohet shprehimisht se Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 6, të nenit 26, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim.

Në rastin konkret pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të dorëzuar nga anëtari i bashkimit ED Konstruksion shpk i cili referuar marrëveshjes së bashkëpunimit ka marrë përsipër përqindjen më të madhe në bashkim përkatësisht 50% të volumit të kontratës rezulton se nuk ka dorëzuar një kontratë të vetme në vlerës 50% të fondit limit. Në këto

kushte KPP gjykon se ED Konstruksin shpk sipas parashikimit ligjor më sipër duhet të dëshmonte se plotëson kushin a ashtu sikundër përcakton në mënyrë taksative neni 74 pika 3 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 e ndryshuar.

III.2.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. KPP gjykon se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kritereve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Në këto kushte, KPP gjykon se anëtari i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë “ED Konstruksion” sh.p.k. nuk e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3./1 gërma a të shtojcës 12, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik “Vëllezerit Hysa” shpk mbi kualifikimin e ofertës së BOE “Bean” shpk & “ED Konstruksion” shpk & “Almo Konstruksion” shpk & “Kombi Invest” shpk në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nuk do të merren në shqyrtim pasi, referuar gjykimin më sipër gjendja faktike dhe juridike e BOE “Bean” shpk & “ED Konstruksion” shpk & “Almo Konstruksion” shpk & “Kombi Invest” shpk do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit



Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

### **Vendos**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Vëllezërit Hysa” shpk për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr.REF-56538-04-22-2020, me objekt “*Rikonstruksioni i rrugës Polis dhe Babje në Bashkinë Librazhd*”, me fond limit 333,331,666 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 26.05.2020 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e BOE “Bean” shpk & “ED Konstruksion” shpk & “Almo Konstruksion” shpk & “Kombi Invest” shpk duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Vëllezërit Hysa” shpk.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr.609 Protokoli; Datë 19.06.2020**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

